

**DEKLARATA
PËR PARIMET E INVESTIMIT
të
Fondit të pensionit privat me pjesëmarrje të
hapur
SIGAL MAX PENSION**

Përmbajtja

Hyrje.....	3
Objektivi i Investimit	3
Strategjia e Investimit	4
Alokimi Strategjik	4
Procesi i administrimit të rrezikut.....	5
Metodat e vlerësimit të rrezikut nga investimi.....	6

Hyrje

Deklarata për parimet e investimit për Fondin e pensionit me pjesëmarrje të hapur **SIGAL MAX PENSION** është përgatitur nga SIGAL UNIQA INVEST sh.a., Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit Privat me pjesëmarrje të hapur dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive (në vijim Shoqëria), dhe miratuar nga Këshilli i Administrimit të Shoqërisë me vendim Nr. 3/1, Datë 30.04.2025, në përputhje me nenin 92, të Ligjit Nr. 76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat” dhe nenin 34 të Rregullores Nr. 154 datë 19.09.2024 “Mbi rregulla të mëtejshme për investimet dhe veprimtarinë e fondit të pensionit privat”.

Deklarata përmban parimet e politikës së investimit të Shoqërisë në lidhje me investimin e aktiveve të Fondeve sipas kërkesave ligjore duke përfshirë nënndarjet më poshtë:

- Objektivat e investimeve;
- Alokimin strategjik të aktiveve duke konsideruar natyrën dhe kohëzgjatjen e detyrimeve për pension;
- Procesin e administrimit të rrezikut;
- Metodatat e vlerësimit të rrezikut nga investimi. Anëtarësimi në Fondin e Pensionit me pjesëmarrje të hapur **SIGAL MAX PENSION**, fonde me kontribute të përcaktuara, ku përfitimet nuk janë të garantuara. Si rrjedhojë rrezikun e investimit në fond e mbart anëtari.

Kjo Deklaratë do të publikohet në faqen zyrtare të shoqërisë do të rishikohet të paktën çdo tre vjet, apo menjëherë nëse ka ndryshime të konsiderueshme në politikat e investimit në përputhje me kërkesat ligjore.

Objektivi i Investimit

Benefitet e daljes në pension që janë të disponueshme për anëtarët e Fondit, të cilëve iu ka lindur e drejta e përfitimit të pensionit, pas plotësimit të kushteve sipas legjislacionit në fuqi, përbëhen nga shuma e kontributeve të bëra në emër dhe në përfitim të tyre, së bashku me çdo kthim nga investimet, pasi është zbritur komision vjetor i administrimit.

Objektivat e investimit përbëjnë rezultatet e dëshiruara të investimeve.

Fondi ka dy objektiva kryesore investimi:

1. Objektivi për normën e kthimit: Fondi synon optimizimin e normës së kthimit duke minimizuar rrezikun, ruajtjen e vlerës së kapitalit dhe likuiditeti për të siguruar të ardhura të mjaftueshme gjatë periudhës së pensionit.
2. Objektivi për Rrezikun: Objektivi për Rrezikun është konsistent me natyrën konservative të investimeve të Fondit dhe normën e kthimit, ku tendenca dhe kapaciteti për të ndërmarrë rrezik është në nivele minimale.

Karakteristikat e objektivave të Fondit në radhë prioriteti janë si më poshtë:

Siguria – investimi i aktiveve të Fondit në instrumente me kredibilitet të lartë siç janë titujt qeveritar dhe të institucioneve financiare ndërkombëtare;

Likuiditeti - ruajtja e një niveli të mjaftueshëm likuiditeti në monedhën Lek për të përmbushur në kohë të gjitha detyrimet e pensioneve;

Kthimi nga investimi – portofoli i investimeve do të ndërtohet me synimin e maksimizimit të kthimit të kushtëzuar nga kufijtë e Rrezikut dhe likuiditetit.

Strategjia e Investimit

Mjetet do të investohen në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 76/2023, datë 21.09.2023, “Për Fondet e Pensionit Privat” dhe të politikës së investimeve të miratuar nga Këshilli i Administrimit të Shoqërisë SIGAL UNIQA INVEST sh.a., gjithmonë duke konsideruar interesin me të mirë të anëtarëve.

Të gjitha investimet do të kryhen duke mbajtur parasysh ruajtjen e vlerës së kapitalit dhe të një niveli të mjaftueshëm likuiditeti, për të përmbushur të gjitha detyrimet e tashme dhe të ardhshme në momentin që këto të fundit bëhen të pagueshme. Fondi i pensionit ka një horizont kohor investimi afatgjatë.

Horizonti kohor përkon me fazën e akumulimit e cila mbaron me daljen në pension. Horizonti kohor i fondit lidhet ngushtë me strategjinë e investimit, e cila kërkon aktive me maturitet që përputhen me këtë horizont. Alokimi i aktiveve do të jetë kryesisht në obligacione afatgjata të emetuara nga Republika e Shqipërisë, të cilat përmbajnë rrezik minimal të kredisë por përmbajnë Rrezikun nga norma e interesit. Një horizont afatgjatë investimi kërkon nevojë minimale të menjëhershme për likuiditet. Në varësi të frekuencës dhe të madhësisë së kontributeve, gjithashtu duke paraqitur profilin e anëtarëve në varësi moshe, përcaktohet nevoja për likuiditet. Madhësia e aktiveve likuide në fond është e lidhur ngushtë me profilin e vjetërsisë së anëtarëve të fondit të cilët mbushin kushtet për përfitimin e pensionit. Gjithashtu, element tjetër është mesatarja dhe frekuenca e kontributeve.

Alokimi Strategjik

Në bazë të Ligjit Nr. 76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”, dhe propozimit të Komitetit të Investimeve, Këshilli i Administrimit ka vendosur Alokimin Strategjik të aktiveve të Fondit të Pensionit me pjesëmarrje të hapur **SIGAL MAX PENSION** sipas tabelës më poshtë:

Lloji i Aktiveve	Shpërndarja strategjike Target
Tituj të Qeverisë Shqiptare	99 % +/-1%
Mjete Monetare, ekuivalentë të tyre & Depozita në banka të licencuara nga Banka e Shqipërisë	1 % +/-1 %
Në total vlera të titujve të borxhit, të emetuara nga bankat dhe institucione financiare jo bankare, që nuk janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar	5% <=

Procesi i administrimit të rrezikut

Për funksionimin e SIGAL UNIQA INVEST Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive është miratuar dhe stafin zbatues, të përqendruar në Departamente: Departamenti i Përfitimeve dhe Kontributeve të Fondeve të Pensionit, Departamenti i Administrimit të Investimeve, Departamenti i Administrimit të Rrezikut, Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit, Departamenti i Shitjeve dhe Departamenti Ligjor, Burime njerëzore & Përputhshmërisë.

Shoqëria administruese ka krijuar edhe strukturat e veta të përbëra nga Degët në Korçë dhe Shkodër.

Gjithashtu, shoqëria administruese përfaqësohet nga degët dhe agjencitë e kompanisë së sigurimeve SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a. bazuar në kontratën e shërbimit midis tyre.

Ndarja e funksioneve midis administrimit të fondeve të pensionit privat dhe administrimit të fondeve të investimit është realizuar duke vendosur struktura të veçanta me përgjegjësi të qarta për secilin funksion.

Departamenti i Përfitimeve dhe Kontributeve të Fondeve të Pensionit fokusohet ekskluzivisht në administrimin e fondeve të pensionit, duke menaxhuar kontributet, shpërndarjen e përfitimeve dhe raportimet ligjore në këtë sektor.

Departamenti i Administrimit të Investimeve, është përgjegjës për menaxhimin e investimeve dhe portofolit financiar, duke garantuar rritjen e vlerës së aktiveve përmes strategjive të specializuara në tregjet financiare.

Drejtuesi i Përputhshmërisë dhe Departamentit Juridik, sigurojnë që të dy strukturat të funksionojnë në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet e qeverisjes së mirë. Në këtë mënyrë, ndarja e funksioneve jo vetëm që garanton efikasitet më të lartë, por edhe shmang konfliktet e interesit, duke krijuar një qasje transparente dhe të qëndrueshme në administrimin e fondeve.

Shoqëria Administruese në mënyrë që të menaxhojë Rrezikun ndaj të cilit është i ekspozuar aktiviteti, ndërmerr masat e mëposhtme:

- Ndarjen e funksioneve të veçanta dhe kontroleve midis Drejtorisë së Administrimit të Portofolit, Drejtorisë së Administrimit të Rrezikut dhe njësisë back-office dhe raportimit financiar.
- Krijimin e një kulture ku kuptimi dhe administrimi i Rrezikut është përgjegjësi e çdo punonjësi të shoqërisë. Punonjësit e çdo njësie njihen me të gjitha rreziqet ndaj të cilave ekspozohet shoqëria dhe fondit, si dhe të jenë të gatshëm që të sigurohen që çdo rrezik që bie mbi njësitë e tyre, po menaxhohet sipas politikave dhe procedurave.
- Promovimin dhe mbështetjen për përthithjen dhe zbatimin e praktikave më të mira të administrimit të rreziqeve.
- Krijimin e njësisë së dedikuar për administrimin e Rrezikut brenda shoqërisë që të identifikojë e të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme risqet, para të cilave janë të ekspozuara aktivet e fondit të pensionit dhe shoqëria administruese, përfshirë, të paktën, Rrezikun e tregut, Rrezikun e kredisë, Rrezikun operacional, Rrezikun e reputacionit, Rrezikun ligjor dhe Rrezikun e agjencisë. Kjo njësi është përgjegjëse për mbikëqyrjen e veprimeve të shoqërisë administruese dhe administrimin nga ana e saj të fondit të pensionit dhe të japë udhëzime të përditshme, për të siguruar se shoqëria administruese,

në funksionet e veta dhe në rolin e administrimit të fondit të pensionit vepron brenda limiteve të Rrezikut, të vendosura nga Këshilli i Administrimit dhe të shprehura në kontratën e fondit të pensionit privat dhe në prospekt.

- Politika e administrimit të Rrezikut udhëhiqet nga natyra e skemës së fondeve dhe tolerancës për rrezik të përcaktuar në objektivat e investimit të fondit.
- Metodologjitë e vlerësimit të Rrezikut mbështeten në praktikat më të mira, si dhe në ligjet, rregulloret dhe standardet kontabël ndërkombëtare.
- Përgjegjësit e proceseve/drejtesit e drejtorive, ose stafi tjetër i përshtatshëm i shoqërisë, kryejnë edhe vetëvlerësime dhe analiza të risqeve operationale që kanë të bëjnë me linjat e tyre të biznesit, të mbështetur nga Drejtoria e Administrimit të Rrezikut.
- Politika e Rrezikut është ndërtuar mbi një qëndrim gjithëpërfshirës, duke konsideruar jo vetëm Rrezikun e aktiveve të fondit, por të gjitha risqet që hasen nga individët gjatë planifikimit për pension.
- Vendosja dhe monitorimi i kufijve për ekspozimet në rrezik gjatë aktivitetit dhe transaksioneve të kryera.
- Përmbushja e nevojave për të siguruar buxhetin e nevojshëm për burimet e strukturave dhe sistemeve të administrimit të risqeve.
- Krijimi i një emri të mirë dhe besimit tek anëtarët e fondit, në lidhje me administrimin sa më të mirë të fondeve në përputhje me të gjitha rregullat dhe ligjet, dhe duke u bazuar në praktikat më të mira.
- Raportimi dhe përputhshmëria e veprimtarisë me rregulloret dhe kërkesat e Autoritetit Mbikëqyrës dhe institucioneve të tjera.

Metodat e vlerësimit të rrezikut nga investimi

Shoqëria administruese ka hartuar një politikë të qartë të administrimit të rrezikut, në përputhje me natyrën dhe madhësinë e aktivitetit të saj, me qëllim identifikimin, matjen, monitorimin dhe kontrollin e rreziqeve, në përputhje me objektivat e investimit të Fondit dhe me mbrojtjen më të mirë të interesave të anëtarëve.

Në vijim detajohen rreziqet kryesore ndaj të cilave ekspozohet Fondit të Pensionit me pjesëmarrje të hapur **SIGAL MAX PENSION**:

Profili i Rrezikut dhe Përfitimit

Rrezik më i Ulët

Rrezik më i Lartë

Përfitime Tipike më të Ulta Përfitime Tipike më të Larta



1	2	3	4	5	6	7
---	---	---	---	---	---	---

	Probalbilieti 1-5	Ndikimi	Niveli total i rrezikut	Masa e menaxhimit
Rreziku i tregut	1	1	1	Diversifikim, ndjekje e tregjeve
Rreziku i likuiditetit	1	1	1	Planifikim i likuiditetit
Rreziku operacional	1	2	2	Trajnime, Automatizim i proceseve
Rreziku i investimit	1	1	1	Investim në tituj me risk të ulët
Rreziku i kreditit	1	1	1	Diversifikim i investimeve, mbikqyrje e rregull
Rreziku politik	1	2	2	Këshillim më ekspertë të politikës
Rreziku i Depozitarit	1	1	1	Përditësim i dokumentave dhe procedurave
Rreziku i agjencisë	1	1	1	Monitorim i performcës
Rreziku i përputhshmërisë	1	1	1	Përditësim i dokumentave dhe procedurave
Rreziku ligjor	1	2	2	Ndjekje e ligjit dhe rregulloreve në Fuqi
Rreziku i reputacionit	1	2	2	Përgjegjshmëri dhe transparencë
Rreziku nga delegimi i funksioneve	1	1	1	Monitorim i vazhdueshëm i aktivitetit

Rreziku i tregut është rreziku i uljes së vlerës së kuotës së fondit që vjen si pasojë e ndryshimit (rënies) të vlerës së investimeve që përbëjnë fondin. Ndryshimi i vlerës së investimeve është rezultat i faktorëve të ndryshëm të tregut si norma e interesit dhe kursi i këmbimit. Duke qenë se Fondi i Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur SIGAL MAX PENSION përbëhet kryesisht nga investime në tituj borxhi të emetuara ose garantuara nga qeveria e Republikës së Shqipërisë, rreziku i tregut për këtë fond përcaktohet nga faktorë lokalë të tregut që në këtë rast është vetëm norma e interesit.

Llojet e rrezikut të tregut janë:

- *Rreziku i Normës së interesit* - Ndryshimi i normave të interesit të titujve të borxhit të emetuara nga qeveria e Republikës së Shqipërisë në monedhën LEKË, ndikon në ndryshimin e çmimit të tregut të këtyre instrumenteve dhe për rrjedhojë ndikon drejtpërsëdrejti në ndryshimin e vlerës neto të aktiveve dhe kthimin nga investimi në fond.
- *Rreziku i Kursit të këmbimit* - Fondi nuk është subjekt i rrezikut të kursit të këmbimit pasi Fondi mbahet në monedhën Lekë dhe investimet bëhen në tregun vendas. Në përgjithësi, nëse fondi do investonte aktive në një monedhë të ndryshme nga monedha e Fondit (Lekë) luhatshmëria e pafavorshme e kursit të këmbimit do të rezultonte në ndryshim të vlerës së aktiveve të kuotuar në monedhë të ndryshme nga Lekë.
- *Rreziku i Inflacionit* - Rreziku i inflacionit përfaqëson mundësinë që vlera reale e investimit të rezultojë më e ulët për shkak të rritjes së çmimeve.

Shoqëria administruese do të kryejë një kontroll cilësor dhe sasior të rrezikut të tregut në mënyrë të vazhdueshme, që të zvogëlojë maksimalisht pasojat negative të tij mbi aktivet e Fondit të Pensionit.

Rreziku i kreditit është rreziku i humbjes financiare për Fondin nëse një palë e një instrumenti financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet e tij kontraktuale. Për qëllime të raportimit të administrimit të rrezikut, Fondi merr në konsideratë këto elemente të ekspozimit ndaj rrezikut të kreditit (si rreziku Individual i mospagimit dhe rreziku i sektorit).

Këshilli Administrativ i Fondit ia ka deleguar përgjegjësinë për administrimin e rrezikut kreditor drejtuesve të shoqërisë Administruese, e cila është përgjegjëse për mbikëqyrjen e rrezikut të kreditit të Fondit. Investimet e Fondit janë në obligacione të Qeverisë së Shqipërisë, ndërsa paratë dhe ekuivalentët e saj janë pranë depozitarit.

Rreziku i likuiditetit është rreziku i krijimit të efekteve negative mbi aftësinë e shoqërisë administruese për të përmbushur detyrimet e saj. Shoqëria administruese kontrollon rrezikun e likuiditetit duke përcaktuar detyrimet dhe procedurat për të disponuar në mënyrë të përhershme sasinë e duhur të aktiveve likuide të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve të saj.

Rreziku i agjencisë është i lidhur me probabilitetin e ngjarjeve që përfshijnë ndërmarrjen e veprimeve apo përdorimin e autoritetit të administratorit të Shoqërisë Administruese apo dhe menaxherëve të portofolit në përfitim individual kundrejt përfitimit të Fondit. Shoqëria Administruese ka implementuar mekanizma kontraktuale dhe të kontrollit për mirëfunksionimin e Shoqërisë Administruese dhe të Fondit, duke siguruar integritetin në të gjitha proceset në përputhje me ligjet, rregullat dhe mbrojtjen e aktiveve të Fondit. Një rol kryesor në proceset e kontrollit ka Banka Depozitare e cila kontrollon transaksionet e anëtarëve të Fondit dhe procesin e investimeve.

Rreziku operacional i referohet humbjeve që mund të ndodhin si pasojë e gabimeve njerëzore në transaksionet e përditshme, sistemeve jo të përshtatshme të informacionit, dështimit të teknologjisë, ngjarjeve të paparashikuara apo procedurave të Shoqërisë Administruese. Në mënyrë që të minimizohet rreziku operacional, shoqëria administruese zhvillon sisteme të përshtatshme kontrolli të brendshëm dhe përcakton saktësisht procedurat dhe rregulloret për të gjithë punonjësit në të gjitha fushat e operacioneve, si dhe në rast eventesh të jashtme.

Gjithashtu Banka Depozitare kontrollon aktivitetin e investimeve dhe të transaksioneve me anëtarët (kontributet dhe shlyerjet).

Rreziku i përputhshmërisë përfaqëson probabilitetin e krijimit të efekteve negative mbi pozicionin e shoqërisë administruese për shkak të mos-zbatimit të rregulloreve, kryesisht të atyre që rregullojnë nivelin e saj të kapitalit dhe parandalimin e pastrimit të parave. Shoqëria Administruese kryen rregullisht vlerësimin e aktiveve, humbjeve të mundshme dhe mundësisë së rritjes së kapitalit, përcakton procedurat e identifikimit dhe parandalimit të pastrimit të parave dhe siguron që kapitali të jetë në nivelin minimal të kërkuar në përputhje me dispozitat ligjore. Në një nivel të jashtëm, kontrolli i përputhshmërisë me rregulloret kryhet nga depozitari.